



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke



Anr.717/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Subjektit politik Kosova Adalet Turk Partisi, me seli në Mamushë e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të rinumërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i palejuar apeli Anr.717/2021 i datës 25.10.2021 i paraqitur nga Subjektit politik Kosova Adalet Turk Partisi, me seli në Mamushë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për shkak të rinumërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale 2021.

A r s y e t i m

Me datën 25.10.2021, PZAP-i ka pranuar një apel nga subjekti politik Kosova Adalet Turk Partisi me seli në Mamushë, me të cilën pretendon se në formular janë të dukshme vëzhguesit e nënshkruar Kaltrina Kasumi dhe Skënder Shala. Sipas parashtruesit të apelit Skënder Shala është kundër subjektit politik të të parashtruesit të ankesës dhe se nuk kanë besim në të, andaj përmes apelit ka kërkuar që të ketë një përfaqësues nga partia e tij deri sa të bëhet regjistrimi ose të formohet një komision nga ana e PZAP-së. Po ashtu parashtruesi i apelit ka kërkuar që votat e votuesve të numërohen nga Komisioni që do formohet nga PZAP dhe të bëhet rinumërimi edhe njëherë.

Paneli, pasi që vlerësoj lejueshmërinë e apelit konstatoj se:

Apeli është i pa lejuar

Paneli pasi që vlerësoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se pretendimi i parashtruesit të ankesës se PZAP, të formon një komision për rinumërim të votave me post, është i palejuar sepse nuk është ne juridiksionin e PZAP-së, për të formuar komision brenda QNR-së, për ti rinumëruar votat. Ndërsa lidhur me kërkesën e parashtruesit të ankesës për rinumërim të fletëvotimeve në këtë fazë që gjendet procesi zgjedhor është e parakohshme sepse ende nuk kemi rezultat përfundimtar i cili rezultat është i ankueshëm.

Hudhja e ankesës nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, në rast se parregullsia e pretenduar nga ankuesi nuk eliminohet për gjatë administrimit në QNR.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.717/2021 më datën 25.10.2021.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-